



## **KUVENDI I KOMUNËS KOMITETI PËR KOMUNITETE**

### **EKSTRAKT**

**nga procesverbali i mbajtur më 29 shtator 2015, në mbledhjen XVII – të (shtatëmbëdhjetë) të Komitetit për Komunitete.**

Mbledhja u mbajt në sallën nr. 31 dhe filloi në orën 11.30’.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z. Shaban Ahmeti, kryesues i këtij Komiteti.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e këtij Komiteti, përkatësisht z. Bahri Selimi, z. Mefail Rama,, z. Shaban Osmani, z. Radisav Perović.z. Xhafer Ademi dhe z. Xhevdet Beselica.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë dhe vendimmarrje.

Në mbledhje ishin të pranishëm edhe Liman Zeqiri, shef i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim, Devolle Topçiu, Ministria për Komunitete dhe Kthim, Fadil Babatinca, Policia e Kosovës, Bashkim Bajrami, Policia Kufitare, Sevdije Buçinca, OSBE, z. Nylias Gergo, LMT, Nevzat Qorrolli dhe Xhavit Fejza, UNMIK.

#### **1. Miratimi i rendit të ditës**

Rendi i propozuar i ditës u miratua njëzëri.

#### **2. Shqyrtimi dhe miratimi i Ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 7 shtator 2015**

Ekstrakti i procesverbalit u miratua njëzëri.

#### **3. Informatë për përfshirjen e nxënësve të komuniteteve RAE në proceset mësimore: parashkollor, fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë duke përfshirë edhe numrin e atyre të cilët studiojnë në fakultete të ndryshme**

**z. Xhafer Ademi**, theksoi, viti i ri shkollor ka filluar mbarë por janë edhe disa vështirësi të cilat nuk kanë qenë evidente vitin e kaluar e kjo ka të bëjë me atë se të gjithë nxënësit e riatdhësuar nuk janë regjistruar në shkollë, pengesat janë te drejtorët e shkollave që nuk po i regjistrojnë të gjithë nxënësit e kthyer por disa po e disa jo, të paregjistruar në shkollë fillore janë 5 nxënës, pra kjo është një mangësi.

Në ciklin parashkollor janë 6 nxënës ndërsa në klasën e I –<sup>rë</sup> të Shkollës fillore të regjistruar janë 19 nxënës. Në Shkollën fillore “ Naim Frashëri “ janë 70 nxënës, në

“ Shaban Shala “ janë 10 nxënës, “ Enver Maloku “ 5 nxënës, në Shkollën fillore “ Ibrahim Rugova “ 42 prej tyre 21 nxënës dhe 21 nxënës, në Shkollën fillore “ Zahir Pajaziti “ në Orllan janë 2 nxënës, në Batllavë 6 dhe në Sfeçël 5 nxënës.

Në shkollat e mesme, këtë vit shkollor, janë të regjistruar vetëm 2 nxënës e kjo është brengë për komunitetin ngase viteve mëparshme kanë qenë mbi 10 nënës në shkolla të mesme. Deri tash nuk ka ndodhur por këtë vit 2 nxënës e kanë përsëritur vitin shkollor.

Gjithashtu në këtë vit shkollor prej komuniteteve RAE nuk është regjistruar asnjë student në fakultet përkundër faktit se dy kanë qenë të interesuar, derisa në mjete të informimit dhe forume të ndryshme flitet se kanë përparësi por kjo në realitet nuk ka ndodhur.

**z. Xhevdet Beselica**, theksoi, në diskutimin tim dëshiroj të ndërlidhem me çështjen e mos regjistrimit të 5 nxënësve në shkollë fillore të cilën e shtroi parafolësi dhe jam i interesuar të di se nxënësit e cekur a kanë aplikuar me kohë apo pas emigrimit janë kthyer me vonesë. Jemi në dijeni se një paralele maksimalisht mund të ketë 32 nxënës mirëpo në rast nevojë janë shtuar paralelet.

**z. Xhafer Ademi**, theksoi, nxënësit në fjalë nga diaspora kanë ardhur më heret por në shkollë janë paraqitur me vonesë, nxënësit prej klasës së I<sup>-rë</sup> deri në klasë të V<sup>-të</sup> janë pranuar dhe janë regjistruar, mirëpo prej klasës VII, VIII dhe IX<sup>-të</sup> nuk janë pranuar. Sipas fjalëve të prindërve dhe nxënësve, nxënësit i kanë vijuar mësimet në Gjermani dhe tash shkolla ka gjetur shkas dhe po ua kërkon certifikatat.

**z. Shaban Osmani**, theksoi, në fjalën hyrëse z. Xhafer Ademi në mënyrë detaje i paraqiti të dhënat për numrin e nxënësve të komuniteteve RAE të cilët mësimet i vijnë në shkollë fillore dhe ato të mesme. Sa i përket nxënësve të cilët nuk janë regjistruar nuk duhet nxituar dhe të fajësohet kushdo çoftë pa e verifikuar gjendjen faktike ngase po e zëmë nëse një nxënës pa emigruar ka qenë në klasë të II<sup>-të</sup> nëse i njëjti nuk e sjellë dëshminë prej shtetit ku ka qenë se e ka kryer klasën e II<sup>-të</sup> ai nuk mund të regjistrohet në klasë të III<sup>-të</sup>, unë jam i mendimit se mos regjistrimi i atyre 5 nxënësve ka të bëjë me këtë çështje. Lidhur me këtë duhet të shqyrtohen mundësit e kryerjes së klasës përkatëse me mësim joformal në mënyrë që të sigurohet dëshmia e nevojshme për regjistrim në një klasë më të lartë.

**z. Xhafer Ademi**, theksoi, me urdhër përkatësisht Vendim të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë është paraparë që të gjithë nxënësit e riadhesuar gjithsesi me u regjistruar në shkolla, vetëm nxënësit e shkollave të mesme të cilët nuk janë të notuar do t'i nënshtrohen provimeve për me vijuar klasën vijuese.

Pajtohem se arsye e mos regjistrimit të 5 nxënësve është se ata nuk i kanë certifikatat e shkollës nga shteti prej të cilit janë kthyer, por nëse pritet derisa të arrijnë ato certifikata ata nxënës nuk do të vazhdojnë mësimin dhe do të mbesin rrugëve.

**Kryesuesi z. Shaban Ahmeti**, theksoi, lidhur me çështjen për të cilën po debatohet unë konsideroj se faji kryesor është te prindërit e nxënësve që nuk i kanë marrë dëshmitë përkatëse. Të gjithë jemi në dijeni se asnjë nxënës nuk mund të kalon në klasën e IV<sup>-të</sup> pa e përfunduar klasën e III<sup>-të</sup>.

**z. Shaban Osmani**, theksoi, të gjithë jemi të interesuar për regjistrimin e atyre nxënësve në veçanti për faktin se ata nxënës janë në kuadër të shkollimit fillor që sipas ligjit është i obliguar por me dispozita ligjore po ashtu është e përcaktuar mënyra e kalimit prej një klase në klasë vijuese dhe askush, kushdo çoftë, nuk

guxon me regjistruar asnjë nxënës nëse në mënyrë të rregullt nuk e ka përfunduar klasën paraprake.

**z. Mefail Rama**, theksoi, lidhur me çështjen për të cilën po debatojmë do duhej të jetë i pranishëm përfaqësuesi i Drejtorisë së Arsimit, mirëpo ne jemi në dijeni një numër i pjesëtarëve të komuniteteve RAE kanë emigruar gjatë vitit shkollor dhe ata fëmijë kanë shkuar në shkalla në shtetin përkatës mirëpo është e sigurt se nuk kanë mundur me mësuar gjuhën që flitet në atë shtet dhe nuk kanë mundur me kaluar klasën në të cilën i kanë vijuar mësimet nga kjo konsideroj se nxënësi duhet të regjistrohet në klasën ku ka ngecë pra në atë klasë ku i ka ndërprerë mësimet.

**Kryesuesi z. Shaban Ahmeti**, theksoi, çështja për të cilën po debatojmë nuk i përket vetëm nxënësve të komuniteteve RAE por kjo ka të bëjë me të gjithë nxënësit pavarësisht cilit komunitet i përket.

**z. Liman Zeqiri**, theksoi, çështjes së mos regjistrimit të 5 nxënësve të komuniteteve RAE t'i japim kushtimisht të them kahje të gabuar ngase shumë herë e kemi cek se nxënësit e komuniteteve të cekura kanë qenë të privilegjuar si në aspektin e regjistrimit në shkolla të mesme, pa kriteret përkatësisht pa iu nënshtruar provimit pranues, pastaj sigurimin e teksteve shkollore për këtë kategori dhe çështje të tjera kur dihet fakti se shumë nxënës të komunitetit shumicë kanë mbetur pa u regjistruar në shkolla të mesme.

Sa i përket problematikës të cilën e ngriti z. Xhafer Ademi, ajo i përket nxënësve të të gjitha komuniteteve, pra nëse nxënësi mbetet i pa notuar apo të emigroj në mes të vitit shkollor dhe të kthehet e të regjistrohet në vitin shkollor vijues, kjo është e pamundur, pra nxënësi përkatës mund të regjistrohet në klasën në të cilën i ka ndërprerë mësimet, por nëse nga shteti ku ka qenë e sjell dëshminë se i ka vijuar mësimet dhe e ka kryer klasën përkatëse kuptohet në këto raste nuk do të ketë kurrfarë problemi, kjo ka të bëjë me nxënësit e të gjitha komuniteteve, andaj mos t'i ngatërrojme temat kinse ka ndasi.

#### **4. Shqyrtimi i gjendjes të riatdhesuarve, pjesëtarë të komuniteteve RAE, të cilët kanë emigruar kohë më parë**

**z. Liman Zeqiri**, shëf i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim, theksoi, jemi dëshmitarë se në vitin 2014 kanë emigruar një numër i caktuar i pjesëtarëve të komuniteteve RAE e pas tyre edhe një numër i madh i pjesëtarëve të komunitetit shumicë dhe kohëve të fundit janë duke u riatdhesuar, mirëpo numri i të riatdhesuarve nuk dihet përveç numrit të atyre të cilët lajmërohen në Institucionet tona.

Jemi në dijeni për legjislacionin në fuqi se të gjithë ata të cilët kanë emigruar pas 28 korrikut 2008 me rastin e riatdhesimit nuk iu njihen disa beneficione që iu njihen atyre të cilët kanë emigruar para datës 28 korrikut 2008 të cilëve për kohë të caktuar iu sigurohet strehimi, ushqimi etj.

Prej të riatdhesuarve kohëve të fundit është lajmëruar familja prej shtatë anëtarëve e z. Avni Tahirit, në këtë rast po ndërldhem me pikën paraprake të rendit të ditës ngase nxënësit e paregjistruar disa janë po të kësaj familje. Familja e z. Avni Tahirit ka emigruar më 8 shtator 2014 ndërsa është riatdhesuar më 26 gusht 2015.

## **5. Të ndryshme**

**Kryesuesi z. Shaban Ahmeti**, theksoi, shfrytëzoj rastin dhe e falënderoj Drejtorinë e Arsimit e në veçanti z. Agim Veliun, Kryetar i Komunës, për ndihmën e ofruar lidhur me sigurimin e 70 teksteve për nxënës të shkollave të mesme për nxënësit e komuniteteve RAE e që një pjesë e tyre iu është ndarë edhe nxënësve të komunitetit shumicë me gjendje të rëndë sociale.

**Mbledhja përfundoi në orën 12.10’.**

**Procesverbalin e mbajti  
Faik Gashi**

**Nr. 01-006- 85500  
Podujevë,  
29 shtator 2015**

**Kryesuesi i Komitetit  
Shaban Ahmeti**